

VENDIM
Nr. 140, datë 24.2.2016

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË, ME
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE
SHOQËRISË “THE STAR” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “SALLA S4, ME
AMBIENTET E SAJ NDIHMËSE”, TË SHOQËRISË “NPV” SHA, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “The Star” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Salla S4, me ambientet e saj ndihmëse”, në katin e tretë teknik (kati i katërt, nga toka, i godinës), në administrim të shoqërisë “NPV” sh.a., Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 550 (pesëqind e pesëdhjetë) m², përkatësisht, sipërfaqe nën objekt 550 (pesëqind e pesëdhjetë) m², sipas genplanit dhe tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN - RILEVIMI ZONA KADASTRALE NUMER: <u>8513</u> NUMRI I PASURISE: <u>173-9 NR VOL. 33 FQ.138</u> INDEKSI I HARTES: <u>F.6-4.5</u> SHKALLA: <u>1:1.000</u> ADRESA E PASURISË: <u>DURRES</u> QYTETI / FISHTAT: <u>DURRES</u> NR.18 RR. H.KERTUSHA PIG.: <u>SH. KATI. AP.</u> PRONAR: <u>SHA NPV - DURRES</u> VULA/FIRMA _____	
---	--

Ne Lagjjen : Nr 18,RR :A.Goga - DURRES.



SALLA S4 me ambientet e saj ndihmese,ndollet ne katin e trete teknik(ose katin e katert nga toka) te godines me 4 kate

	Siperfaqja nen ndertese eshte	550 m ²
	Siperfaqja funksionale (jo nen ndertese)	—
	Siperfaqja e pergjithshme	550 m ²

GEZİM ÇULAK

GEZİM ÇULAK